



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/765
Datë: 23/9/2024

Senati i Universitetit të Prishtinës, bazuar në kompetencat e përcaktuara sipas nenit 20 të Statutit të UP-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 18.9.2024, mori këtë:

V E N D I M
mbi kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studimeve themelore baçelor

Neni 1

Studentët e Universitetit të Prishtinës mund të regjistrojnë vitin vijues të studimeve po qe së i plotësojnë kushtet si në vijim:

1. Vitin e dytë të studimeve mund ta regjistrojnë ata studentë të cilët i kanë fituar së paku 60% të numrit të përgjithshëm të kredive, përkatësisht tërësisë së provimeve në lëndët mësimore të vitit të parë të studimeve, (studentët e të gjitha drejtimeve të Fakultetit të Arteve në kuadër të 60% duhet ta kalojnë edhe lëndën kryesore e cila bartet në vit).
2. Vitin e tretë të studimeve mund ta regjistrojnë ata studentë të cilët i kanë fituar së paku 50% të numrit të përgjithshëm të kredive, përkatësisht tërësisë së provimeve nga lëndët mësimore të vitit të parë të studimeve, (studentët e të gjitha drejtimeve të Fakultetit të Arteve në kuadër të 50% duhet ta kalojnë edhe lëndën kryesore e cila bartet nga viti në vit).
3. Përfundimisht nga pika 2, studentëve të Programit Matematikë, Programi Fizikë në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore dhe studentëve të degës së Veterinës në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, i'u lejohej që ta regjistrojnë vitin e tretë të studimeve nëse kanë arritur së paku 45% të numrit të përgjithshëm të kredive, përkatësisht lëndëve mësimore të vitit të dytë të studimeve.
4. Vitin e katërt të studimeve mund ta regjistrojnë ata studentë të cilët i kanë fituar së paku 30% të numrit të përgjithshëm të kredive, përkatësisht tërësisë së provimeve nga lëndët mësimore të vitit të tretë të studimeve, (studentët e të gjitha drejtimeve të Fakultetit të Arteve në kuadër të 30% duhet ta kalojnë edhe lëndën kryesore e cila bartet nga viti në vit).
5. Përfundimisht nga pika 4, studentëve të Programit Matematikë në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore dhe studentëve të degës së Veterinës në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, i'u lejohej regjistrimi në vitin e katërt të studimeve nëse kanë arritur së paku 25% të numrit të përgjithshëm të kredive, përkatësisht lëndëve mësimore të vitit të tretë të studimeve.
6. Studentëve të Programit Veterinari në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, i'u lejohej regjistrimi në vitin e pestë të studimeve nëse kanë fituar së paku 20% të numrit të përgjithshëm të kredive, përkatësisht lëndëve mësimore të vitit të katërt.

7. Studentëve të Programit Arkitekturë në Fakultetin e Arkitekturës, i'u lejohet që ta regjistrojnë vitin e pestë të studimeve pa kushte të caktuara të numrit të kredive, përkatësisht lëndëve mësimore nga viti paraprak.
8. Vitin e pestë, përkatësisht të gjashtë të studimeve, studentët e Fakultetit të Mjekësisë mund ta regjistrojnë pa kushte të caktuara të numrit të kredive, përkatësisht lëndëve mësimore nga viti paraprak.
9. Për fakultetet/programet në të cilat disa lëndë specifike dëgjohen dhe vlerësohen në vitin pasues, ECTS kreditë do të llogariten vetëm në vitin e studimeve në të cilin studenti vlerësohet me notë.

Neni 2

Studenti është i obliguar që në vitin pasardhës t'i japë paraprakisht provimet e mbetura nga viti paraprak e pastaj të fillojë dhënien e provimeve në vitin në të cilin është i regjistruar.

Neni 3

1. Gjatë ndërrimit të programit të studimeve, studentit i lejohet të fillojë programin e ri të studimit nëse se paku 50% të provimeve janë dhëne me sukses gjatë programit të vjetër të studimeve dhe që pranohen në programin e ri të studimeve.
2. Studentit i lejohet që të regjistrohet në programin e ri të studimeve:
 - 2.1. Më së paku në vitin e dytë të studimeve; ose
 - 2.2. Në vitin e studimeve që vijon pas programit të vjetër të studimeve.
3. Ndërrimi i programeve mund të lejohet deri në 5% nga numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në vitin vijues akademik në degën përkatëse të fakultetit.
4. Në Fakultetin e Mjekësisë ndërrimi i programit të studimeve mund të lejohet vetëm nga viti i tretë i studimeve, deri në 5% nga numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në vitin vijues akademik në degën përkatëse të fakultetit.
5. Në raste të veçanta me lejen e rektorit mund të bëhet përjashtim nga kriteri i përcaktuar si në paragrafin 4 të këtij neni.

Neni 4

Ngjashëm me paragrafin 2, 3, 4 dhe 5 të nenit 3 të këtij vendimi, mund të lejohet edhe transferimi i studentëve nga universitetet tjera të akredituara.

Neni 5

Studenti mund të kërkojë një herë që t'i vazhdohet kohëzgjatja e studimeve për një (1) apo dy (2) vite. Vendimin e merr këshilli i njësisë akademike. Në rast se merret vendim pozitiv studenti do ta ketë sërish statusin e studentit të rregullt.

Neni 6

1. Statusi i studentit të rregullt mbahet brenda dy (2) viteve pasi studentit t'i ketë përfunduar të gjitha provimet. Gjatë kësaj kohe studentit duhet të japë provimin e diplomës që t'i përfundoj me sukses studimet.
2. Studenti që e ka tejkaluar kohën e paraparë për të përfunduar me sukses diplomën mund të paraqesë kërkesë të dekani i njësisë akademike për zgjatjen e kësaj periudhe edhe për një vit.
3. Studenti i cili një vit pas vërtetimit të semestrit të fundit nuk i përfundon studimet sërish e regjistron vitin e studimeve me pagesë.

Neni 7

1. Studenti mund të kërkojë suspendim të përkohshëm nga statusi i studentit të rregullt në rastet e dëshmuara si të:
 - 1.1. Sëmundjes së rëndë;
 - 1.2. Kujdesit për fëmijët nën moshën tri vjeçare;
 - 1.3. Shtatzënisë dhe lehonisë;
 - 1.4. Tjera të justifikuar.
2. Vendimin përfundimtar lidhur me kërkesën si në paragrafin 1, e merr dekani i njësisë akademike.
3. Periudha e suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt në bazë të këtij Statuti, nuk llogaritet në kohëzgjatjen e studimeve.

Neni 8

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimi me nr. prot. 2/172, datë 28.9.2023.

Neni 9


Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi janë njësitë akademike të UP-së.

Neni 10

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Senati i UP-së dhe vlenë deri në një vendim tjetër.

Vendimi t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Dekanëve fakulteteve;
3. Sekretarëve të fakulteteve;
4. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së.



Kryesues i Senatit të UP-së

Prof. dr. Oqtim Qerimi - Rektor